



## KONTRATE-SHITBLERJE

### TE KUOTAVE TE KAPITALIT THEMELOR TE SHOQERISE "CO.GE.FI" SHPK

Ne Tirane, sot ne date 12 / 10 / 1999 (netedhjetenente), para meje Notere Blerina Avrazi, me seli ne Rr.e Durrës, u paraqiten palet;

**Zoterinjte; Moreno Torri, Moreno Bai, Massimo Torri dhe Francesco Prinzi, te perfaqesuar nga Z. Moreno Torri, lindur ne Cantagallo (I) me 25.01.1950 dhe banues ne Prato Rruga Rugero Nuti n.25, madhor e me zotesi te plate juridike, identifikuar me pasaporten Nr.574692L, i cili vepron jo vetem per vehte por edhe si perfaqesues me prokura te posaçme n.8795,8796,8797. te dates 10 qershor 1999, i ortakeve Moreno Bai, Massimo Torri e Francesco Prinzi me te cilet se bashku posedojne 100% te kuotave te kapitalit themelor te shoqerise "CO.GE.FI.", "SHITESA"**

#### DHE

**Z. Vehip Guri, i biri Muharrem, lindur ne Gjirokaster me 01.09.1942 dhe banues ne Tirane Rr.P.Myzeqari P.30.Ap.13, madhor me zotesi te plate juridike dhe per te vepruar, identifikuar me leternjoftimin e tij personal Nr.QH010786, ci cili vepron per vehte si "BLERESE";**

#### T e cilet bazuar ne faktet se;

Zoterinjte Moreno Torri, Moreno Bai, Massimo Torri dhe Francesco Prinzi, jane pronare te 100% (njqindperqind) te kuotave te kapitalit themelor te shoqerise "CO.GE.FI." Sh.p.k. pronesi e cila vertetohet nga vendimi i Gjykates Nr.19.234 date 14.04.1998, si dhe mbeshtetur ne vendimin e asamblese se ortakeve te shoqerise "CO.GE.FI." Shpk date 20.gusht 1999,

**Si dhe ne nenet 705 e vijus te K.C.kane rene dakort te lidhin kete kontrate ne kushtet si vijon:**

#### NENI 1.

Zoterinjte Moreno Torri, Moreno Bai, Massimo Bai dhe Francesco Prinzi, nepermjet perfaqesuesit te tyre ligjor, i shesin Z. Vehip Guri, 100% (njqind) te kapitalit themelor te shoqerise "CO.GE.FI." Sh.p.k., ne vleren nominale 100.000 Leke (njqindmije).

#### NENI 2.

Bleresi Z. Vehip Guri e pranon çmimin e shitjes dhe e paguan ate menjehere duke marre nga shitesit nje deftese qe verteton pagesen.

#### NENI 3.

Shitesit nepermjet perfaqesuesit te tyre garantojne bleresin se kuotat e kapitalit themelor te shoqerise "CO.GE.FI." Sh.p.k. jane te lira nga çdo barre apo hipoteke dhe njeheresh lehtesisht te posedueshme nga bleresi. Gjithashtu garantojne bleresin se shoqeria nuk ka borxhe ose gjoba per te paguar.

#### NENI 4.

Me nenshkrimin e kesaj kontrate shitesit Moreno Torri, Moreno Bai, Massimo Torri dhe Francesco Prinzi, zhvishen menjehere nga pronesia mbi 100% (njqind) te kuotave te kapitalit themelor te shoqerise "CO.GE.FI." shpk dhe, pronar i vetem dhe i ligjshem i ketyre 100% (njqindperqind) te kuotave te kapitalit themelor te shoqerise "CO.GE.FI." Shpk, behet menjehere Z. Vehip Guri i cili nga ky moment do te gezoje edhe te gjitha te drejtat qe burojne nga ky veprim, si pronar dhe ortak i vetem ne shoqerine "CO.GE.FI." Shpk.

Kjo kontrate eshte readaktuar ne kater kopie te njejta,dhe pasi lexohet nga palet edhe ne gjuhen Italiane nga perkthyes i pranuar prej tyre Luan Bega, dhe gjendet e shkruar sipas vullnetit te tyre te lire,firmoset ne pranine time dhe une noteria vertetoj firmat e tyre duke patur cilesite qe me jep ligja.

**PALET KONTRAKTUESE**

**SHITESI**

PER VEHTE DHE ORTAKET :

MORENO BAI, MASSIMO TORRI, FRANCESCO PRINZI  
ME PROKURA TE POSACME N.8795,8796.8797,dt.10.06.'99  
MORENO PAOLO TORRI

*Moreno Paolo Torri*

**BLERESI**

Ing.VEHIP GURI

*Vehip Guri*  
*Shkruar*

**NOTERE  
BLERINA AVRAZI**

